

Vrapimi i Solidaritetit

Fleta e Mësuesit

Vlerat

Solidariteti, Mirëkuptimi, Respekti, Altruizmi, Dhembshuria.

Qëllimet

Pedagogjike: Stimulimi i analizimit, reflektimi dhe debati rreth personave me aftësi të kufizuara.

Praktike: Analizimi i sjelljes së atletëve me aftësi të kufizuara në histori dhe analizimi i përkufizimit nga Mário Quintana.

Pjesëmarrësit

Minimumi: 5 pjesëmarrës
Maksimumi: 20 pjesëmarrës

Kohëzgjatja

45 minuta

Materialet

Fleta e nxënësit
Stilolaps dhe letër

Përmbledhje

Mësuesi/ja organizon nxënësit në grupe me 5-6 nxënës. Secili nxënës lexon historinë “Lojërat Olimpike Speciale të Seattle” dhe përkufizimet nga Mário Quintana, individualisht dhe në heshtje. Në grupe, ata duhet të mbajnë shënime në lidhje me impresionet dhe refleksionet e tyre rreth asaj që lexojnë. Më pas duhet të përpiqen të imagjinojnë të njëjtën histori me njerëz që nuk kanë aftësi të kufizuara, duke krahasuar rezultatet dhe pasojat dhe duke reflektuar së bashku.

Shënim

Gjatë kohës së prezantimit në grupe, mesuesi/ja mund të mbajë shënime dhe të shkruajë përfundimet kryesore në tabelë.

Diskutimi

Çfarë ju tërhoqi më shumë vëmendjen në këtë histori?


A do të kishin të njëjtën sjellje njerëzit që nuk kanë aftësi të kufizuara? Pse?

Si i shpjegoni këto ndryshime në sjellje?

Nëse do të ishit ju, si do të vepronit në lidhje me kolegun që u pengua gjatë garës?

Çfarë mendoni në lidhje me këndvështrimin e shkrimtarit rreth llojeve të ndryshme të aftësive të kufizuara?

A njihni ndonjë person me aftësi të kufizuara në familjen tuaj, në shkollë apo në lagje? Flisni zakonisht me të? Çfarë ndjeni kur i/shihni? Pse?



Vrapimi i Solidaritetit

Fleta e Nxënësit

Lexoni individualisht historinë “Lojërat Olimpike Speciale të Seattle” dhe përkufizimet nga Mário Quintana rreth çështjes së aftësive të kufizuara.

Lojërat Olimpike Speciale të Seattle

Disa vite më parë, në Lojërat Olimpike Speciale të Seattle të vitit 1992, nëntë pjesëmarrës, të gjithë me aftësi të kufizuara mendore, u rreshtuan për fillimin e garës së vrapimit 100 metra.

Pas sinjalit të gjithë ata u nisën, jo duke vrapuar vërtetë, por të përkushtuar për të dhënë më të mirën e tyre, të mbaronin garën dhe të fitonin.

Njëri nga atletët u pengua në pistë, ra dhe filloi të qante. Të tjerët dëgjuan të qarën, ngadalësuan hapin dhe shikuan mbrapa. Pastaj ata u kthyen dhe po ecën mbrapa drejt tij. Të gjithë.

Një nga vajzat me Sindromën Daun u ul në gjunjë, e puthi personin dhe i tha:

- Ja, tani do të shërohet!

Në vazhdim, të gjithë konkurentët u kapën prej krahu me njëri-tjerin dhe së bashku shkuan deri në vijën e mbarimit. I gjithë stadiumi u ngrit në këmbë dhe duartrokitjet vazhduan për shumë minuta. Ndoshta atletët ishin me aftësi të kufizuara mendore... por ata me siguri nuk ishin të tillë shpirtërisht.

(përshtatur nga burimi i Komitetit Paralimpik Brazilian)

Aftësitë e kufizuara

Mário Quintana (Shkrimtar brazilian lindur në 30/07/1906; i vdekur në 05/05/1994)

"**I mangët**" është dikush që nuk mund të ndryshojë jetën e tij/saj duke pranuar imponimet e të tjerëve ose të shoqërisë në të cilën jeton, duke mos pasur ndërgjegjen se secili është zot i fatit të tij/saj.

"**I marrë**" është dikush që nuk përpiqet të jetë i lumtur me atë që ka.

"**I verbër**" është dikush që nuk i sheh njerëzit që ka përreth tij/saj duke vdekur nga i ftohti, uria, mjerimi dhe vetmia dhe përqendrohet vetëm te problemet dhe dhimbjet e tij/saj.

"**I shurdhër**" është dikush që nuk ka kohë të dëgjojë ngashërimat e një miku apo thirrjen për ndihmë të vëllait sepse është gjithmonë duke u marrë me punë për të siguruar të ardhurat e dhura në fund të muajit.

"**Memec**" është dikush që nuk mund të thotë çfarë ndjen dhe fshihet pas maskës së hipokrizisë.

"**Paralitik**" është dikush që nuk mund të ecë drejt atyre që kanë nevojë për të.

"**Diabetik**" është dikush që nuk mund të jetë i ëmbël.

"**Xhuxh**" është dikush që nuk di se si ta lërë dashurinë të rritet.

